



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1001/8 Prot.

Tiranë, më 14. 11. 2024

V E N D I M

Nr. 275, datë 14. 11. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr.148 Regj., datë 04.07.2024 e znj. R. M, kundër Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, dhe “çdo shkak tjetër”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, ndër të tjera informon se: *“Unë, R. S. M, lindur në Vlorë më 28.03.1994, banuese në Tiranë, prej 6 vitesh kam mbajtur detyrën e specialist-juriste në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Gjatë këtyre viteve, nga të gjitha auditimet që më janë bërë nga KLSH, nuk më është konstatuar asnjë shkelje; nuk kam asnjë masë administrative, as për kryerjen e detyrave të mia funksionale dhe as për paraqitjen në orarin e punës. Ndërkohë, me shkresën nr. 1031, datë 09.02.2023, kam marrë një "Referencë" si vlerësim pozitiv për punën time. Në datën 07.02.2024, së bashku me 5 persona të tjerë (4 femra dhe 2 meshkuj), u njoftuam për diskutimin e marrëdhënies së punës; nuk e përjetova mirë as nga ana emocionale, as nga aspekti i shëndetit fizik. U paraqita tek mjekja e familjes në një gjendje jo të mirë shëndetësore, e cila më rekomandoi të mos paraqitem në punë me simptomat që kisha, të dokumentuara në Raportet Shëndetësore të datave 12.02.2024-17.02.2024 dhe 19.02.2024-24.02.2024.*

Në datën 26.02.2024, u paraqita në institucion, ku konstatoj se të gjithë kolegët e zyrës kishin marrë një email zyrtar në lidhje me një Anketë nga Zv. Drejtori Ekzekutiv, dhe konstatoj se inbox-i i email-it tim ishte jashtë funksionit. Në orën 9 u paraqita tek Sektori i Burimeve Njerëzore, duke ju bërë me dije se në rast se do të kishte një njoftim për mua, të më njoftonin në një mënyrë tjetër pasi

¹Për shkak të qëndrimit të kundërt me z. B. P, Shefi i Sektorit të Çështjeve Administrative Gjyqësore, lidhur me procesin gjyqësor të AKBN me subjektin paditës “Store Production” sh.p.k., etj.

email-i i punës ishte jashtë funksionit. Në datën 29.02.2024, u njoha me shkresën nr. 984/1 prot., datë 29.02.2024, "Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës". Në rastin e njoftimit tim, institucioni më diskriminoi duke mos më trajtuar në mënyrë të barabartë, siç veptoi në rastin T apo M, të cilët, pasi morën shkresën e njoftimit, filluan procesin e diskutimit të marrëdhënieve të punës. Mënyra se si u diskriminuan 4 femra është konstatuar nga KLSH, nga faqa 24-26. AKBN në rastin e largimit tim më ka diskriminuar edhe për mënyrën se si më ka trajtuar lidhur me përzgjedhjen e emrit tim brenda Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore. Në shkresën nr. 984/1 prot., datë 29.02.2024, institucioni më njofton se procedura e largimit tim nga puna është për shkak të pamundësisë financiare të institucionit. Ndërkohë, në datën 23.01.2024, u punësua një punonjëse e re; Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i komisionit që bëri largimet për shkak të pamundësive financiare, a nuk ishte në dijeni se pas dy javësh do të bëhej shkurtimi i punonjësve për këtë motiv? A nuk do të duhej AKBN të mbante parasysh në përzgjedhje kriteret që i përcakton Kodi i Punës, si për shembull vlerësimet pozitive apo vjetërsinë në punë?

AKBN, nga data 23.01.2024 deri më sot, datë 03.07.2024, ka bërë 15 rekrutime të reja. A qëndron pamundësia financiare si shkak për të bërë 4 largime? Për të marrë përgjigjen e këtyre pyetjeve iu drejtova Drejtorit Ekzekutiv me shkresën nr. 984/2 prot., datë 29.02.2024, por asnjëherë nuk mora përgjigje. Ju drejtova edhe Inspektoriatit të Punës, por me shkresën nr. 2494/2 prot., datë 29.05.2024 "Kthim përgjigje", më drejtoi tek ju për trajtimin e diskriminimit. Mendoj se është cënuar parimi i transparencës në rastin tim, pasi, referuar nenit 45 të K.P.A, institucioni, së bashku me shkresën nr. 984/1 prot., datë 29.02.2024, duhet të më kishte përcjellë edhe vendimarrjen e komisionit. Pasi bëra kërkesë për t'u njohur me këtë vendimarrje, institucioni me shkresën nr. 1506/3 prot., datë 02.05.2024, refuzon të më vërë në dispozicion këto procesverbale dhe kopjen e referencës së sipërcituar të njehësuar".

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit. Nuk dëshiron të rikthehet në punë pasi ndihet e kanosur.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: "Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Nëpërmjet shkresës me nr.1001/1 prot., datë 10.07.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa.
- Me shkresën nr. 984/8 prot., datë 26.07.2024, është administruar pranë Komisionerit shkresa nr. 1109 prot., datë 31.07.2024 e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, me anë të së cilës është përcjellë informacioni i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar.
- Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, shkresën nr. 1109/1 prot., datë 05.08.2024 të Komisionerit, drejtuar ankueses, i është përcjellë për kundërshtime, së bashku me gjithë informacionin dhe dokumentacionin e dërguar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
- Shkresa e mësipërme është kthyer nga shërbimi postar, dhe për këtë arsye i është ridërguar nga inspektori i çështjes me anë të email-it të datës 02.08.2024.
- Me shkresën nr. 1001/2 prot., datë 12.08.2024, janë administruar pranë Komisionerit kundërshtimet e ankueses në lidhje me shkresën nr. 984/8 prot., datë 26.07.2024 të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
- Me email-in e datës 23.08.2024, ankuesja ka përcjellë informacione të tjera në lidhje me çështjen, si dhe Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të kryer pranë institucionit, i cili ka trajtuar ndër të tjera edhe rastin e ankueses.

Mbështetur në nenin 33/8 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1001/3 prot., datë 04.09.2024, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 24.09.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio, dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 24.09.2024, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, znj. R. M, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,

përfaqësuar nga z. B. P, me autorizim nr. 984/2, datë 23.09.2024. Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

1. Në vijim të kërkesave të Komisionerit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me email-in e datës 09.10.2024, depozitoi pranë KMD-së kopje të dokumentacionit të kërkuar gjatë seancës dëgjimore.
2. Me shkresën nr. 1313 prot., datë 29.09.2024, rezultoi se është përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një kërkesë padi me palë dhe objekt: Padi të: R. M; I Paditur: AKBN; Palë e tretë: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, me objekt: Shpërblim dëmi.
3. Me email-in e datës 24.10.2024, ankuesja i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si më poshtë: *Përshëndetje. Së pari, vlerësoj përkushtimin e institucionit tuaj mbi mënyrën e trajtimit të rastit tim deri në këtë fazë, me profesionalizëm, objektivitet dhe racionalitet. Unë, R. M, kam paraqitur ankesën time në KMD me nr. 148, datë 04.07.2024, për diskriminim në punë për shkak si: gjinia dhe çdo shkak tjetër. Në datën 08.09.2024, kam paraqitur një kërkesë-padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në këtë kërkesë-padi ju kam thirrur edhe ju në cilësinë e personit të tretë. Duke qenë se gjykimi në këtë gjykatë mund të fillojë në çdo moment dhe për të mos e trajtuar të njëjtin problem dy herë, kërkoj pezullimin e çështjes pranë KMD dhe trajtimin e saj në gjykatë.*

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se, në objekt të kërkesë-padisë së ankueses drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Referuar kërkesë-padisë, rezulton se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është thirrur në cilësinë e palës së tretë. Ndërkohë, sipas email-it të datës 24.10.2024, ankuesja i ka kërkuar Komisionerit pezullimin e trajtimit të ankesës së saj, për arsye se kjo çështje po trajtohet nga Gjykata.

Në bazën ligjore të vendosur në kërkesë-padinë e depozituar pranë Gjykatës, regjistruar me datë 24.02.2024, ankuesja ka cituar shprehimisht: *"Nenet 120, 140, 144, 145, 146 të Kodit të Punës dhe Nenet 31, 32, 153, 154, të Kodit të Procedurës Civile i ndryshuar"*.

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesja, ndër të tjera, citohet se:

Më shkresën Nr. 984/1, datë 29.02.2024, "Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës", njoftohet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të vështirësive financiare në datën 31.05.2024.

Ndërkohë, institucioni më datën 23.01.2024, ka bërë rekrutime për Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore. Dy javë më pas, vendosi të bëjë 6 largime nga puna për shkak të vështirësive financiare, 2 meshkuj dhe 4 femra. Procedura për 2 meshkujt u ndërpre, ndërsa për 4 femrat vazhdoi. Ky veprim nga ana e AKBN bie në kundërshtim me nenin 9 të Kodit të Punës, "Ndalimi i diskriminimit". Fakti që procedura e largimit vazhdoi vetëm për 4 femra është konstatuar gjithashtu në Projekt-Raportin e KLSH Nr. 866, datë 02.04.2024. KLSH konstaton se a duhet të ishin bërë rekrutime të reja, pasi institucioni do të ndërmerre iniciativën për të larguar punonjës me përvojë.

Gjatë kësaj periudhe, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore janë bërë 16 punësime të reja, fakt ky që rrëzon pretendimin e AKBN ndaj palës paditëse "për shkak të vështirësive financiare". Ndërkaq, kryetari i Komisionit për të kryer largimet nga puna ishte Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore, i cili dy javë më parë kishte paraqitur kërkesë për punësim për specialist-jurist në DSHL, duke qenë se kishte pasur dijeni për vështirësitë financiare. Referuar Projekt-Raportit të KLSH, faktohet se nga ana e kryetarit të Komisionit që largoi punonjësit nuk janë nënshkruar Proces-Verbalet e punonjësve të larguar për këtë shkak.

A nuk përbën shkak për pavlefshmëri vendimmarrja e anëtarëve të tjerë të këtij Komisioni? Në vlerësimin tim, vlefshmëria e veprimeve të këtij Komisioni duhet të ishte në unanimitet; në të kundërt, do ta bënte atë të pavlefshme. A është i vlefshëm Urdhëri i Drejtorit Ekzekutiv për të ngitur një grup pune me punonjës të të njëjtit nivel hierarkik për të bërë largime nga puna? A mund të konsiderohet e ligjshme procedura e largimit kur vendimmarrja nuk është bërë në unanimitet?

Duke qenë se paditësja nuk ka marrë njoftim për takimin e datës 26.02.2024, veprime të cilat bien ndesh me nenin 144 të Kodit të Punës, AKBN nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë paditësen siç është vepruar për rastet e tjera që kanë qenë me Raport Shëndetësor. I padituri ka kryer një sërë veprimesh të kundraligjshme për të penguar dhe diskriminuar palën paditëse: bllokimi i email-it për të mos u njohur me njoftimin, mosdhënia e Librezës së Punës, mosdhënia e proces-verbalëve të datave 13.02.2024, 19.02.2024, 26.02.2024, të cilat duhet të ishin bashkëlidhur shkresës Nr. 984/I, datë 29.02.2024, "Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës". Në momentin e njoftimit të shkresës së sipërcituar, AKBN ka vepruar në kundërshtim të nenit 45 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit përcaktohet:

"1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. 2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për kërkuesin, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik ose në përfaqësitë konsullore dhe diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit."

Edhe pse ka pasur kërkesa të njëpasnjëshme nga pala paditëse, institucioni nuk ka marrë asnjë masë për të plotësuar garancitë dhe mbrojtjen që dikton ligji, por haptazi, nëpërmjet shkresës Nr. 1506/3, datë 02.05.2024, "Kthim përgjigjë", Drejtoria e Administratës shkel këto të drejta duke refuzuar të japë informacion.

Lidhur me ndalimin e diskriminimit, referuar nenit 18 të Kushtetutës, nenit 9 të Kodit të Punës, si dhe ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", paditësja i është drejtuar edhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me ankesën Nr. 148, datë 04.07.2024.

Nëse analizojmë më hollësisht shkakun që AKBN ka njoftuar palën paditëse nëpërmjet shkresës Nr. 984/1, datë 29.02.2024, kuptojmë se kemi të bëjmë me një veprim i cili është i pavlefshëm nga pikëpamja ligjore dhe që vjen në kundërshtim me nenin 92 të Kodit Civil.

Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmëdhjetë vjeç; ç) bëhen me marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).

Sikurse argumentohet në Vendimin Unifikues Nr. 5, datë 30.10.2012, "Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit të themelit të çështjes nga gjykata ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij. Pasojat e ardhura nga ekzekutimi i një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi kërkesën e palëve..."

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, citohet se veprimet e ndërmarra nga ana e punëdhënësit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, kundrejt paditëses znj. R. M, janë diskriminuese dhe në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi. Ndër këto dispozita, përmenden neni 18 i Kushtetutës, neni 9 dhe neni 146 i Kodit të Punës, si dhe ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, pala ankuese, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar, ndër të tjera, trajtimin e pabarabartë, të padrejtë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me largimin e saj nga puna. Ajo ka kërkuar dëmshpërblimin përkatës, duke i paraqitur Gjykatës të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë Komisionerit.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

"...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen

kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr.148, datë 04.07.2024, paraqitur nga znj.R. M, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj².

² Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, datë 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.

Neni 33, pika 7/4 e LMD nuk e lidh marrjen dijeni me ndonjë moment të caktuar të procedurës. Kushti që kërkohet nga dispozita e sipërcituar është vetëm fakti që çështja të jetë në shqyrtim, pra të mos ketë përfunduar shqyrtimi i saj me vendim nga ana e Komisionerit.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë³, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 148, datë 04.07.2024, të paraqitur nga ankuesja znj. R. M, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.